

VENDIM
Nr. 495, datë 22.7.2014

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 693, DATË 10.11.2005, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPALLJEN E KOMPLEKSIT LIGATINOR TË BUTRINTIT “PARK
KOMBËTAR””, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, pika 1, shkronja “b”, 4/2, 6 e 13, të ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për zonat e mbrojtura”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 693, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të fjalisë së parë, të shkronjës “a” të pikës 4, pas fjalës “. mesdhetare .” shtohen fjalët “. dhe zona të trashëgimisë kulturore e natyrore, përfshirë zonat arkeologjike të trashëgimisë kulturore “Park antik”.”.

b) Pas pikës 4 shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

“4.1. Nënzonat e shënuara në hartë me shkronjën A3, me sipërfaqe të përgjithshme 614,3 (gjashtëqind e katërmëdhjetë presje tre) ha, kalojnë në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe në përdorim të Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, institucion në varësi të kësaj ministrie.”.

c) Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. Ngarkohet Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit për menaxhimin e nënzoneve A3, në përdorim të saj, e cila, së bashku me komitetin e menaxhimit të këtij parku e në bashkëpunim me institucionet e specializuara, të realizojnë menaxhimin e përgjithshëm të Parkut dhe të kontrollojnë zbatimin e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar.”.

ç) Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” dhe “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave” zëvendësohen, përkatësisht, me “ministra përgjegjëse për trashëgiminë kulturore” dhe “ministra përgjegjëse për mjedisin”.

2. Ngarkohet Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit për të hartuar planin e menaxhimit të zonës.

3. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për kryerjen e regjistrimit, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama